



EKSTREMIZMI, RADIKALIZMI DHE TERRORIZMI

RAPORT

NË KUADËR TË

PROJEKTIT

“PARANDALIMI I EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM DHE RADIKALIZMIT NË BASHKINË ROSKOVEC DHE ZONAT RURALE NË KËTË BASHKI”

Ky projekt u zbatua nga Qendra “Gruaja, Komuniteti, Mjedisi” në bashkëpunim me Qendrën për Nisma Ligjore Qytetare dhe u mbështet financiarisht nga projekti “Shoqëria Civile kundër Ekstremizmit të Dhunshëm” i cili u financua nga Bashkimi Evropian dhe u zbatua nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Komiteti Norvegjez i Helsinkit, Komiteti Holandez i Helsinkit, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Serbi dhe shoqata “Together for Life”, Shqipëri.

**ROSKOVEC
MARS, 2018**



“Ky dokument është prodhuar në kuadër të projektit “Parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit në Bashkinë Roskovec dhe zonat rurale në këtë Bashki” i zbatuar nga “Qendra Gruaja, Komuniteti, Mjedisi” mbështetur financiarisht nga projekti “Shoqëria Civile kundër Ekstremizmit të Dhunshëm” i cili financohet nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e organizatës zbatuese dhe në asnjë rast nuk reflekton apo përfaqëson domosdoshmërisht mendimin apo qëndrimin e KSHH-së dhe as të Bashkimit Evropian”.

“This document has been produced in the context of the project “Prevention of violent extremism and radicalism in Roskovec and rural areas of this municipality”.” implemented by “Qendra Gruaja, Komuniteti, Mjedisi” with the financial supported from the project “Civil Society Countering Violent Extremism” with funds of the European Union. The contents of this document are the sole responsibility of implementing organization and can under no circumstances be regarded as reflecting the position of the of AHC nor the European Union”.

Ky raport u hartua nga ekspertët e projektit:

Sandër SIMONI, Manjola XHAXHO, Arbër LLOSHI,

në bashkëpunim me ekspertët e “Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare”:

Av. Aurela BOZO, Av. Iris ALIAJ

Në vitet e fundit dhe veçanërisht pas ngjarjeve të 11 Shtatorit 2001, fenomenet e ekstremizmit, radikalizmit dhe terrorizmit kanë fituar një vëmendje të konsiderueshme mediatike, ligjore, ekonomike dhe politike pasi janë përhapur në një masë të konsiderueshme duke shkaktuar problematika dhe pasoja të natyrave të ndryshme kryesisht, të shfaqjes së dhunës në shoqëritë ku ato janë zhvilluar duke prekur një sërë shtetesh të tjera. Këto fenomene rishtazi kanë gjetur shprehje më të kristalizuara dhe të fuqishme në Shtetin Islamik në Irak dhe Levant/Shami (term gjeografik që i referohet gjysmëhënës pjellore). Në përgjigje të këtij fenomeni nga shtetet e prekura janë ndërmarrë masa të ndryshme deri ushtarake, të cilat kanë pasur si synim luftimin, kufizimin dhe ndalimin e tij. Megjithatë, krahas këtyre masave, për të arritur sukses në zhdukjen e këtij fenomeni, parandalimi paraqitet si domosdoshmëri. Shqipëria, si pothuaj çdo vend tjetër, mund të ndikohet nga rryma ekstremizmi, radikalizmi dhe terrorizmi. Raste të shfaqjes së tyre tashmë janë vënë re. Prandaj, është vlerësuar e nevojshme që në kuadër të projektit “Shoqëria Civile kundër Ekstremizmit të Dhunshëm” të zhvillohet dhe ky Projekt, i cili ka si qëllim parësor pikërisht, parandalimin e këtyre fenomeneve në një zonë të varfër në Shqipëri siç është ajo e Roskovecit.

Ky Raport përbën një material përmbledhës dhe informativ të hartuar në kuadër të Projektit me qëllim a) parashtrimin e një tabloje të përgjithshme të problematikave të ndryshme nga fenomenet e ekstremizmit, ekstremizmit të dhunshëm, radikalizmit dhe terrorizmit dhe fenomeneve të tjera të ngjashme; b) ndërgjegjësimin dhe informimin e publikut, si dhe c) krijimin e kushteve dhe eksperiencave për parandalimin e rasteve të mundshme të ekstremizmit, radikalizmit dhe terrorizmit, por pse jo dhe rasteve të tjera të dhunës, nga ato të thjeshtat e deri tek format më të organizuara dhe sofistikuara.

Raporti është hartuar nga ekspertët e projektit në bashkëpunim me QGKM dhe QNL për t’iu adresuar subjekteve të targetuara nga Projekti, pra qytetarëve dhe institucioneve të ndryshme në Bashkinë Roskovec.

Në këtë kuptim, ky Raport duhet të konsiderohet si një tablo e përgjithshme e natyrës informuese dhe jo si një material i mirëfilltë akademik dhe/ose shkencor mbi çështjet objekt studimi dhe për këtë shkak i largohet rregullave formale të një materiali akademik me qëllim qenien më pranë grupeve të interesit dhe i kuptueshëm për shtresa të ndryshme shoqërore, veçanërisht për qytetarët e bashkisë në të cilën zhvillohet Projekti.

PËRMBAJTJA

KAPITULLI

1.	Metodologjia dhe Interpretimi	1
2.	Koncepte dhe përkufizime	1
3.	Historiku dhe zhvillimi	4
4.	Shkaqet e fenomenit	6
5.	Pasoja, financimi dhe parandalimi	7
6.	Margjinalizimi dhe ekstremizmi e radikalizmi	8
7.	Statistika të fenomenit	10
8.	Legjislacioni në fuqi	11
9.	Jurisprudenca shqiptare dhe botërore	14
10.	Mësime nga përvoja	20
11.	Mjetet qendrore dhe vendore për luftimin e ekstremizmit dhe radikalizmit	24
12.	Familja dhe individi si faktorë parandalues dhe kufizues	25
13.	Roli që mund të luajnë në parandalimin e fenomenit shoqëria civile, besimet dhe organizatat fetare	25
14.	Bashkëpunimi ndërmjet aktorëve të ndryshëm, veçanërisht komunitetit dhe organeve vendore për parandalimin dhe luftën ndaj këtij fenomeni	26
15.	Konkluzione	27
16.	Bibliografi	28

1. METODOLOGJIA DHE INTERPRETIMI

Për shkak të karakteristikave të tij, ky Raport ka si qëllim parashtrimin e një tabloje të përgjithshme e gjerësisht të pranueshme dhe kuptueshme të fenomeneve objekt shqyrtimi dhe për këtë pasojë metodat e përdorura në të janë kërkimi, sistematizimi dhe përgjithësimi i materialeve publike e të aksesueshme, si dhe informacioneve e eksperiencës së ekspertëve dhe organizatave të përfshira.

Megjithatë, pavarësisht sa më sipër, në këtë Raport përfshihen informacione të sakta dhe gjerësisht të pranuar mbi çështjet dhe përmbajtja e tij karakterizohet nga përpjekja e vazhdueshme për t'u qëndruar dhe referuar burimeve të besueshme, por pa u kufizuar vetëm në aktet normative në fuqi, duke përfshirë praktikën dhe jurisprudencën e Gjykatave shqiptare dhe të huaja, raporte të organizmave dhe organizatave kombëtare dhe ndërkombëtare, fjalorëve të ndryshëm, etj.

Për qëllime praktike në tekst janë përdorur akronime dhe/ose shprehje me kuptime të veçanta, të cilat do të kenë kuptimin në vijim:

- **QGKM**, i referohet organizatës joqeveritare “Qendra Gruaja, Komuniteti, Mjedisi” me qendër në Roskovec, Fier, Shqipëri.
- **QNL**, i referohet organizatës joqeveritare “Qendra për Nisma Ligjore Qytetare” me qendër në Tiranë, Shqipëri.
- **Projekti**, i referohet projektit “Parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit në Bashkinë Roskovec dhe zonat rurale në këtë bashki” i zbatuar nga QGKM mbështetur financiarisht nga projekti “Shoqëria Civile kundër Ekstremizmit të Dhunshëm” i cili financohet nga Bashkimi Evropian.
- **Raporti**, i referohet tërësisë së këtij raporti të hartuar në kuadër të Projektit.

2. KONCEPTE DHE PËRKUFIZIME

Ekstremizmi, ekstremizmi i dhunshëm dhe radikalizmi janë fenomene globale të kohës së sotme të cilat kanë vënë në vështirësi shoqëritë në zhvillim, shtetet e varfra dhe sigurinë publike në nivel botëror. Këto fenomene kanë marrë zhvillim në kuadër të diversiteteve kulturore, fetare, lëvizjeve të pakontrolluara të popullsisë nga vende të ndryshme, por janë përhapur veçanërisht pas konflikteve të armatosura civile e zhvillimeve në vendet e Lindjes së Mesme. Edhe Shqipëria është e përfshirë dhe rrezikuar në vijim nga këto fenomene, të cilat kanë shkaqe kulturore, ekonomike e sociale të shumta. Si fenomene ideologjike ato dalin në pah tek persona të cilëve u mungon formimi i mirë kulturor. Fenomenet e ekstremizmit, ekstremizmit të dhunshëm e radikalizmit shfaqen në formën e ideve, bindjeve dhe shoqërohen me

sjellje e veprime të dhunshme, që shpeshherë shkaktojnë dëm në jetën e njerëzve, pasiguri publike, terror, etj.

Si terma dhe objekte kryesore studimi të këtij Raporti, termat ‘ekstremizëm’, ‘ekstremizëm i dhunshëm’, ‘radikalizëm’ dhe ‘terrorizëm’, kërkojnë një vëmendje të veçantë në drejtim të saktësisimit dhe sqarimit të kuptimeve të tyre përmes përkufizime të sakta. Kjo, për shkak se këto terma a) janë gjerësisht të përdorura në media dhe medime të ndryshme shpesh duke i dhënë kuptime jo plotësisht të sakta, si dhe b) paraqesin ngjashmëri ndërmjet tyre. Megjithëse në ambiente akademike dhe profesionale ka diskutime të shpeshta në lidhje me përkufizimin e saktë teknik të tyre, termat ‘ekstremizëm’, ‘ekstremizëm i dhunshëm’, ‘radikalizëm’ dhe ‘terrorizëm’, kanë përkatësisht kuptimet si më poshtë vijon:

- **Ekstremizmi**¹: nënkupton mbrojtjen dhe promovimin e masave ekstreme, të cilat lidhen me kërkesa dhe veprime për ndryshimin e beftë dhe të menjëhershëm të situatës politike, ekonomike, shoqërore, financiare, etj. Termi ka një përdorim të gjerë, jo vetëm në fushën politike, apo gjeopolitike, por dhe në përditshmërinë tonë. Në parim ekstremizmi lidhet me zhvillimin e ideve të reja dhe jo me rikthimin si mbizotëruese të ideve të vjetra dhe/ose konservatore. Në vetvete ekstremizmi nënkupton aktivitete (besime, qëndrime, ndjenja veprime, strategji), të cilat ndryshojnë shumë nga e ‘zakonshmja/normalja’. Por vetë koncepti i ‘të zakonshmes/normalës’ paraqitet problematik, pasi shpesh është e paqartë çfarë është dhe çfarë nuk është ‘e zakonshme’ dhe si rrjedhojë, çfarë është dhe çfarë nuk është ekstreme dhe cili është subjekti që i vlerëson ato: individi, grupe të caktuara të shoqërisë, shteti, besimet fetare, shumica e popullsisë, apo segmente të caktuara të saj, teoritë shkencore tradicionale, etj. Kjo problematikë qëndron edhe tek fenomenet e tjera që do të trajtohen më poshtë, madje shfaqet edhe më problematike dhe e mprehtë në rastin e terrorizmit. Pra, “ekstremizmi” është fenomeni i të shprehurit të qëndrimeve ekstreme mbi besimin, moralin, nacionalitetin në kundërshtim me parimet gjerësisht të pranuar të ideologjisë, besimit tradicional fetar, apo tërësisë së përgjithshme të parimeve e elementëve nacionalë që refuzon mundësinë e bashkëjetesës së mendimit të ndryshëm.

Ekstremizmi: mund të përkufizohet vetëm në lidhje me ideologjinë më të gjerë, që vepron p.sh. në kuadër të nacionalizmit ekstrem, ambientalizmit ekstrem, ekstremizmit fetar. Tipari përkufizues i ekstremizmit është refuzimi i një ose më shumë parimeve bazë të ideologjisë së saj kryesore. Një

¹ Sipas fjalorit të gjuhës angleze të Oksfordit (*Oxford English Dictionary*) me termin ‘ekstremist’ përkufizohet një person i cili ka pikëpamje ekstreme politike dhe fetare, veçanërisht dikush i cili mbështet veprime të paligjshme, të dhunshme dhe ekstreme.

nacionalist, i cili i konsideron pjesëtarët e të gjitha kombeve të tjera si inferiorë, ose që refuzon mundësinë e bashkëjetesës, apo beson se të tjerëve duhet t'u mohohen të drejtat, është një nacionalist ekstremist. Një besimtar fetar, i cili dënon udhëheqësit ose pjesën më të madhe të anëtarëve të besimit të tij është një ekstremist. Ekstremist është dhe një person i cili i shfaq idetë e tij në mënyrë të prerë e të kundërt me moralin e përgjithshëm. Ekstremistët nuk janë medoemos të dhunshëm

- **Ekstremizmi i dhunshëm:** Nënkupton një formë të ekstremizmit e cila kërkon dhe promovon ndërmarrjen dhe kryerjen e masave të dhunshme për të ndikuar dhe shkaktuar ndryshime të menjëhershme dhe të shpejta të *status quo*-s (gjendjes ekzistuese) në kuptimin ideologjik, fetar, politik, shoqëror, etj. Në kohët e fundit, ky term është përdorur gjerësisht për të përshkruar veprimet e grupeve të ndryshme të cilët promovojnë ndryshime të thella e të shpejta në aspekte të ndryshme shoqërore e që ndikohen dhe frymëzohen nga faktorë të ndryshëm fetarë, historikë, patriotik, filozofik, etj.
- **Radikalizmi:** Është një term i ngjashëm me ekstremizmin, i cili gjithashtu nënkupton prirjen për të promovuar dhe mbështetur elemente dhe ide të cilat nuk janë të zakonshme, të përhapura, ose gjithëpranuara në realitetin, ose në kohën e krijimit të këtyre ideve radikale. Po ashtu ky term nënkupton promovimin e ndryshimeve ekstreme në pikëpamjet, sjelljet, kushtet dhe/ose institucionet ekzistuese. Ndryshe nga ekstremizmi, radikalizmi është më tepër i lidhur me aspektet dhe elementët politikë dhe shpesh lidhet me kërkesën për të rikthyer si mbizotëruese idetë e vjetra konservatore në drejtimin e politikës. Në kohët moderne termi po përdoret gjerësisht për të përshkruar idetë dhe grupet e nxitura nga interpretime të caktuara të besimeve fetare, të cilat janë ekstreme dhe radikale për nga natyra e tyre.
- **Terrorizmi:** Me këtë term kuptojmë akte të dhunshme me qëllim krijimin e frikës (terrorit) dhe që kryhen për arsye bindjesh të ndryshme fetare, politike ose ideologjike, duke pasur si objektiv kryesor civilët (ose duke cenuar sigurinë e tyre) dhe që kryhen përgjithësisht nga agjenci jo-qeveritare, shpesh me qëllim arritjen e synimeve politike. Në krahasim me termat e mësipërm, termi terrorizëm është më i kufizuar në kuptim të fushës dhe veprimeve që ai përfshin, por njëkohësisht përkufizimi i tij paraqet problematika doktrinare dhe politike aq sa shpesh divergjencat janë kaq të mëdha, sa që studime të

ndryshme parashtrojnë deri në rreth 100 përkufizime për të. Terrorizmi është një lloj i veçantë i ekstremizmit të dhunshëm.²

Ekstremizmi dhe radikalizmi për shkak të tipareve kryesore që kanë, identifikohen sot me atë fetar, por jo gjithmonë janë të tillë. Gjithashtu dhe ekstremizmi fetar nuk është gjithmonë në kuptimin e atij islam, pasi dhe besimet e tjera nxisin ekstremizëm. Kryesisht këto fenomene sot identifikohen me shfaqjet ekstreme të një pjese të besimit islam, të nxitura dhe nga konfliktet e armatosura civile në Lindjen e Mesme. Kjo pasi disa rryma besimesh ekstreme fetare i bënë ideologjitë e tyre fetare si kauzë, duke tërhequr mijëra persona rreth vetes në një lëvizje ndërkombëtare me qendër konfliktin e armatosur civil në Siri e Irak në të ashtuquajturin ‘xhihad’ (luftën e shenjtë kundër armiqtë të fesë islame). Aktivitete të tilla janë mbështetur dhe bazuar në disa rryma fetare ekstreme si *vahabizmi*, *salafizmi* e *tekfirizmi*.

Duhet theksuar se si rrjedhojë e ngjarjeve të 11 Shtatorit 2001 në New York dhe Luftës Kundër Terrorizmit që i pasoi ato, përdorimit të termave të mësipërm i është dhënë një ngjyrim negativ, të cilit i referohen shpesh mediet dhe aktorë të tjerë jo akademikë ose jo të specializuar. Për shkak të ngjashmërive ndërmjet tyre, në vijim do të shqyrtojmë dhe analizojmë aspekte të ndryshme të këtyre fenomeneve shpesh së bashku, pa i ndarë dhe diferencuar ato.

3. HISTORIKU DHE ZHVILLIMI

Ekstremizmi dhe radikalizmi, pavarësisht përhapjes dhe përdorimit të gjerë në kohët moderne, shpesh duke u lidhur me një ngjyrim/përmbajtje negative, janë fenomene dhe aspekte të cilat e kanë shoqëruar gjithmonë shoqërinë njerëzore, pasi në thelb ato janë rryma që kërkojnë ndryshimin e saj, duke kushtëzuar kështu zhvillime të reja në shoqëri. Me termin “ekstremist”, “radikal”, por edhe “terrorist”, janë etiketuar persona dhe ide të cilat më pas janë përkrahur dhe promovuar në shoqëri e kthyer në ide mbizotëruese. Raste të tilla janë të shumta në historinë e shoqërisë njerëzore si në fushën filozofike, politike, shkencore, fetare, apo dhe ekonomike. Të tillë janë etiketuar personazhe si Lucius Junius Brutus dhe aristokratët romakë që rrëzuan monarkinë në Romën antike, Perikliu me reformat e tij demokratike në Athinë, Giordano Bruno me teorinë e heliocentrizmit, Lëvizja Radikale në Mbretërinë e Bashkuar e fund të shek. XVIII që kërkonte fuqizimin e parlamentarizmit, filozofët iluministë që formuluan teoritë mbi të Drejtën Natyrore dhe të drejtat e njeriut, revolucionarët francezë, apo dhe deri kryengritësit e shumtë të lirisë të popujve të ndryshëm që etiketohen shpesh si ‘ekstremistë’, “radikalë”, apo edhe ‘terroristë’ nga pushtuesit.

² Vendimi Kuadër i BE për Luftën kundër Terrorizmit, 2002. Gjithashtu në Strategjinë Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm të miratuar përmes VKM Nr. 930 datë 18.11.2015 dhe planin e veprimit për realizimin e saj jepen dhe disa përkufizime në lidhje me këto fenomene që janë të ngjashme me sa më lart.

4. SHKAQET E FENOMENIT

Faktorët që ndikojnë në zhvillimin e rrymave ekstremiste, radikale dhe/ose terroriste, janë të ndryshëm dhe tepër të larmishme. Në fakt ka qenë pothuaj e pamundur të identifikohen një numër faktorësh specifikë ndikimi i të cilëve në këto fenomene, të mbështetëj si kryesor nga një numër i konsiderueshëm studiuesish në fushë.. Në këtë kuptim, studiues të ndryshëm kanë arritur të identifikojnë disa faktorë, të cilët ndikojnë në këto fenomene dhe ndër më kryesorët janë:

- rryma dhe interesa të caktuara politike, të cilat promovojnë ekstremizmin dhe radikalizimin deri dhe terrorizmin për arritjen e qëllimeve të tyre;
- sjellje individuale dhe grupe, si: “identifikimi me karaktere të caktuara”, “ofendimet dhe etiketimet”, “identifikimi i grupeve të ndryshme si ‘të këqij’”, “mungesa e argumenteve dhe zëvendësim i tyre me dhunë”, “mentaliteti i grupit”, “pranueshmëria e dhunës” të cilat përdoren për një kohë të konsiderueshme, si dhe justifikohen si të tilla etj.;
- marxhinalizimi i grupeve të ndryshme dhe mos pranimi i ndryshimit dhe ndryshimeve i cili shpesh shkakton që të dy palët t’i drejtohen dhunës dhe veprimeve a ideve ekstreme për zgjidhjen e situatës;
- evoluimi i sjelljeve nga mania dhe obsesioni tek fanatizmi dhe ekstremizmi (p.sh. fanatikët fetarë);
- marxhinalizimi, shtypja, shfrytëzimi, diskriminimi, poshtërimi, varfëria, trajtimi i pabarabartë dhe sjellje e trajtime të tjera të ngjashme, të cilat janë të gjitha veprime dhe sjellje që mund të krijojnë në psikologjinë e individëve, ose grupe të caktuara shoqërore (si p.sh. grupet e shtypura) idenë apo bindjen se ushtrimi i dhunës është i nevojshëm për të realizuar ndryshime në shoqëri, ose për të shtypur palën tjetër në mënyrë që të ruhet pozita dominuese; dhe
- shpesh shkaqet e këtyre sjelljeve, veprimeve dhe/ose ideve, mund të jenë dhe thjesht psikologjike, të shtyra nga ndjenja vetë-shkatërrimi, urrejtjeje, pasigurie, humbjeje, apo vuajtjeje personale, etj.

Megjithatë, pavarësisht sa më sipër, ekzistojnë disa karakteristika që janë të përbashkëta për të gjitha lëvizjet, aktivitetet dhe/ose qëndrimet e idetë ekstremiste dhe/ose fundamentaliste, që janë:

- kundërshtimi i skajshëm i pikëvështrimeve të ndryshme/kundërta;
- justifikimi i mjeteve të ndryshme për të arritur qëllimin (përfshirë dhunën);
- mungesa e tolerancës ndaj disidentëve dhe zërave ndryshe brenda grupit; dhe
- demonizimi dhe mohimi i mundësisë për kompromis me palët kundërshtarë.

5. PASOJA, FINANCIMI DHE PARANDALIMI

Në varësi të llojit të aktivitetit dhe grupit në të cilin ai kategorizohet, por dhe të ideologjisë së promovuar e fushës së ndikuar, metodat e përdorura nga grupet

ekstremiste, radikale dhe/ose terroriste ndryshojnë mjaft. Grupet ekstremiste, qoftë të ekstremit të djathtë, të majtë apo të qendrës, përdorin metoda të ndryshme duke filluar nga tubimet paqësore, diskutimet publike dhe/ose private, shpërndarja e pamfletëve dhe publikimeve e studimeve, përdorimi i mjeteve të informimit masiv, e deri tek tubimet e dhunshme, protestat, grevat, duke përfshirë edhe aktet terroriste. Nga ana tjetër, ekstremizmi i dhunshëm, sikurse vetë emërtimi i tij, gjithmonë përdor metoda të dhunshme për të mbështetur qëllimet e tij si tubime dhe protesta të dhunshme, akte sporadike dhe të organizuara dhune, presioni fizik dhe psikologjik, zhvatje, vjedhje, krim të organizuar dhe deri në akte terroriste.

Në varësi të qëllimeve dhe ideologjisë së mbështetur, grupet dhe rrymat radikale përdorin një mori mjeteve për të arritur qëllimet e tyre. Pavarësisht se në të shkuarën termi radikalizëm gjente një përdorim më të gjerë në kuptim të rrymave që gruponte, në kohët moderne ai po përdoret më tepër për të identifikuar grupe ekstremiste të frymëzuara nga ideologji fetare të cilat përdorin mjete të dhunshme për arritjen e qëllimit, duke filluar nga pengmarrjet, propaganda, presionet, tubimet, aktet terroriste dhe deri tek kryengritjet e armatosura.

Nga ana tjetër, si kategoria më e dhunshme nga të katërta dhe e cila për nga vetë natyra e saj dhunën e ka pjesë integrale të aktivitetit, terrorizmi përdor, përveç sa më sipër edhe sulmet me mënyra, mjete, në objekte dhe në momente që përshkallëzojnë dhe rrisin impaktin e tyre në opinionin publik. Grupet terroriste gjithashtu përdorin edhe stërvitje të vazhdueshme, fshehja dhe integrimi në popullatën e gjerë, apo dhe komunikacioni me mjete të posaçme, të cilat i japin atyre karakteristika të grupeve militare.

Për sa i përket burimeve të financimit dhe mbështetjes së aktivitetit të tyre, në varësi edhe të llojit, tipareve, qëllimeve e madhësisë së tyre, grupet ekstremiste, radikale dhe terroriste financohen në forma dhe madhësi të ndryshme, duke filluar nga kontributet e anëtarëve të tyre, tek mbështetja e dhënë nga grupe të ndryshme njerëzish, ose nga segmente a shtresa të ndryshme shoqërore që kanë interesa të përbashkëta, entitete të ndryshme qoftë tregtare, fetare, ose organizata 'bamirëse', bashkëpunimi me krimin e organizuar, financimi nga shtete të tjera a organizata ndërkombëtare, ushtrimi i veprimtarive të paligjshme, etj.

Gjithashtu, duhet theksuar se grupet ekstremiste jo gjithmonë janë të unifikuar dhe shpesh brenda tyre ka një larmishmëri të theksuar në ide, qëndrime, kërkesa dhe për këtë shkak vlerësimi i tyre duhet gjithmonë të jetë i kujdesshëm dhe i specializuar.

Për të luftuar, parandaluar dhe prapësuar fenomenet e ekstremizmit të dhunshëm, radikalizmit dhe terrorizmit, duhet të ndiqen politika të caktuara të cilat synojnë të luftojnë dhe zvogëlojnë impaktin e faktorëve të cilat ndikojnë në shtimin e këtyre fenomeneve. Në këtë kuptim, disa nga politikat ndërkombëtare që ndiqen dhe kanë

qenë të suksesshme, por që mund të aplikohen dhe në rastin e Shqipërisë dhe të Bashkisë së Roskovecit janë:

- miratimi i legjislacionit për ndalimin dhe deri kriminalizimin e sjelljeve të caktuara, të cilat ndikojnë në zgjerimin dhe thellimin e fenomenit, si kryerja e aktiviteteve terroriste, ushtrimi i dhunës, përjashtimit, shtypjes, shfrytëzimit, diskriminimit, kur këto rrezikojnë të shkaktojnë sjellje të caktuara, etj.;
- ofrimi i ndihmës ekonomike për familjet në nevojë, krijimi i mundësive të punësimit dhe ndërprerja e mjeteve të financimit të organizatave që ndikojnë në rritjen e ekstremizmit, radikalizmit dhe terrorizmit;
- krijimi i mundësive dhe urave të bashkëpunimit ndërkombëtar, qoftë me vende të zhvilluara, por dhe me ato që kanë treguar eksperiencë dhe efikasitet në zgjidhjen e problemeve të ngjashme;
- caktimi i personave profesionistë në organet shtetërore, qendrore dhe lokale që trajtojnë këtë problem specifik; dhe
- bashkëpunimi i vazhdueshëm ndërmjet shoqërisë civile, institucioneve të arsimit dhe edukimit, atyre fetare dhe njësisive të qeverisjes qendrore dhe vendore me qëllim identifikimin e problematikave, rasteve konkrete, realizimin e fushatave të sensibilizimit dhe informimit, shpërndarjes dhe transferimit të eksperiencave, ideve, diskutimeve publike dhe private, projekteve të ndryshme profesionale dhe të natyrave të tjera të ngjashme, etj.

6. MARGJINALIZIMI, EKSTREMIZMI E RADIKALIZMI

Sikurse u parashtrua më lart, është pothuaj e pamundur të identifikohet një faktor, ose një numër i kufizuar faktorësh të cilët të përkrahen dhe pranohen nga pjesa më e madhe e studiuesve si faktori/ët i/e/të vetëm që ndikon/jnë në lindjen, rritjen dhe zhvillimin e ekstremizmit dhe radikalizmit nëpër botë. Megjithatë, studime dhe studiues të shumtë në këtë fushë kanë arritur në përfundimin se ndërmjet marxhinalizimit, deprivimit ose perceptimit të abuzimit me pushtetin dhe ekstremizmit e radikalizmit ekziston një lidhje e drejtpërdrejtë dhe e thellë. Ndër studimet më të fundit që kanë arritur në këtë përfundim është studimi i financuar nga Kombet e Bashkuara, me titullin “*Marginalization, perceived abuse of power pushing Africa’s youth to extremism – UN study*” (“Marxhinalizimi dhe perceptimi i abuzimit me pushtetin nxit rininë afrikane drejt Ekstremizmit”), publikuar më 7 Shtator 2017³, i cili gjithashtu bazohet dhe shfrytëzon të dhëna nga studimi tjetër i financuar nga UNDP “*Journey to Extremism in Africa: Drivers, Incentives and the Tipping Point for Recruitment*” (Udhëtim tek ekstremizmi në Afrikë: Shkaqet, nxitësit dhe pika e kthesës për Rekrutimin”), i publikuar në vitin 2017⁴.

³ Shiko: <https://news.un.org/en/story/2017/09/564472-marginalization-perceived-abuse-power-pushing-africas-youth-extremism-un-study>.

⁴ Për më tepër shiko: <http://journey-to-extremism.undp.org/content/downloads/UNDP-JourneyToExtremism-report-2017-english.pdf>.

Sipas këtyre studimeve, por dhe nga raporte e studime të tjera, rezulton se shumë prej individëve që i bashkohen ekstremizmit të dhunshëm kanë qenë subjekt marxhinalizimi e diskriminimi gjatë jetës së tyre, duke filluar nga fëmijëria. Mungesa e perspektivës ekonomike, ose pjesëmarrjes reale civile dhe mungesa e besimit në shërbimet publike dhe respektin e të drejtave të njeriut nga Shteti, shpesh bëjnë që një individ i cili përjeton raste abuzimi pushteti mund të shndërrohet dhe kthehet në një ekstremist të dhunshëm. Sipas studimeve të referuara më lart, 71 për qind e të rekrutuarve të intervistuar kanë deklaruar se momenti i kalimit dhe shndërrimit në një ekstremist të dhunshëm ishte momenti kur ato përjetuan dhe dëshmuan një veprim ‘të padrejtë’ shtetëror dhe në pjesën më të madhe të raste me termin ‘veprim’ nënkuptohej arrestimi, ose vrasja e një të afërmi dhe/ose miku, ose padrejtësi të cilat kanë shkaktuar mjerim ekonomik a varfëri për pjesë të popullatës. Studimi gjithashtu arriti në përfundimin se përgjithësisht, ekstremistët e dhunshëm janë persona që vijnë nga rajone kufitare, ose periferike të cilat nuk përfitojnë shumë shërbime dhe vëmendje nga shteti dhe nuk kanë aspak besim në sistemin politik e shoqëror që ekziston në vendet e tyre dhe jetojnë në kushte ekonomike të disfavorshme.

Pra, lidhja ndërmjet marxhinalizimit dhe radikalizmit të dhunshëm është provuar katërcipërisht dhe për të shmangur pjesëmarrjen dhe bashkimin e individëve të marxhinalizuar me grupet e ekstremit të dhunshëm, janë propozuar një mori masash si më poshtë vijon:

- qeveritë nuk duhet të ndërmarrin kryesisht masa ushtarake kundër ekstremizmit të dhunshëm, por në luftimin e tij duhet të respektojnë ligjshmërinë dhe të drejtat e liritë themelore të njeriut;
- pushteti qendror duhet të mbështesë pushtetin vendor në ndërhyrjet kundër ekstremizmit, si p.sh.: iniciativat e nisura nga komuniteti, shoqëria civile dhe bashkëpunimi me elementët fetarë që promovojnë tolerancën;
- një ndër mënyrat më të suksesshme të luftimit të fenomenit është dhe luftimi dhe mposhtja e ideologjisë që i justifikon ato, pasi është vërtetuar se humbja e besimit tek ideologjia përkatëse i shtyn individët të tërhiqen nga grupet ekstremiste, radikaliste dhe terroriste; dhe
- në çdo rast, organet shtetërore duhet që aktivitetin kryesor për luftimin e ekstremizmit t’ia delegojnë organeve dhe organizmave lokale që janë më pranë individëve të prekur.

Si përfundim, duhet theksuar se luftimi i fenomeneve të ekstremizmit, radikalizmit dhe terrorizmit është një aktivitet kompleks i cili në pararojë të tij duhet të ketë luftimin dhe kundërshtimin e fenomenit në rrënjë, duke u munduar të përmirësojë të gjitha elementet të cilat e shkaktojnë atë në tërësinë e tyre dhe jo vetëm njërin nga aspekteve dhe as duke përdorur vetëm një element kundërshtues të kufizuar. Përdorimi i forcës duhet të vlerësohet vetëm si mjeti i fundit për luftimin e tyre dhe në çdo rast duhet të respektohen parimet dhe rregullat e të drejtave dhe lirive themelore

të njeriut të cilat bëjnë të mundur trajtimin e njëjtë të individëve dhe shmangien e diskriminimit dhe marxhinalizimit.

7. STATISTIKA TË FENOMENIT

Duke filluar nga gjysma e dytë e shek. XX dhe veçanërisht në fillim të shek. XXI fenomenet e ekstremizmit të dhunshëm, radikalizmit dhe terrorizmit kanë pësuar një zhvillim dhe përparim të gjerë duke krijuar pasoja negative të shumta nëpër botë. Kështu, nga viti 1972 e deri më sot, bota ka përjetuar rreth 171,000 sulme terroriste me një bilanc prej rreth 200,000 viktime. Një pjesë e konsiderueshme e viktimave ka qenë pas viteve '90 pasi para kësaj periudhe objektivi i terroristëve ishin më tepër diplomatët, por tanimë popullsia civile është kthyer në objektiv parësor të tyre (p.sh. vetëm grupi terrorist Boko Haram ka shkaktuar të paktën 17,000 viktime dhe miliona të tjerë refugjatë). Studiuesit Blomberg, Hess, dhe Weerapana, pas një studimi të kryer në vitin 2004 arritën në përfundimin se një sulm terrorist i kryer në një vend të caktuar, ul GDP-në e atij vendi me 0.57% dhe gjithashtu i shkakton një vendi një kosto të ngjashme me një "taksë sigurie/taksë terrorizmi" si kosto shtesë për sigurinë (p.sh. në SHBA kosto e tillë llogaritet në rreth 500 miliard dollarë amerikanë).

Në vitet e fundit, e veçanërisht pas "Pranverës Arabe", zhvillimit të Luftës civile në Siri dhe fuqizimit të Shtetit Islamik një fenomen tepër problematik ishte ai i personave të cilët shkojnë të luftojnë në konfliktet që zhvillohen në vende të tjera, kryesisht në Lindjen e Mesme. Këto individë, jo vetëm që janë subjekt i ideologjive ekstremiste, radikale dhe terroriste e zhvillojnë veprimtari të tilla në ato vende, por shpesh shoqërohen edhe nga të afërm dhe familjarë të tyre dhe me rikthimin në vendet e origjinës ndikojnë dhe shkaktojnë zhvillimin e këtyre fenomeneve në këto vende, veçanërisht nëse nuk trajtohen rregullisht dhe në mënyrën e duhur. Kështu, rreth 22 mijë persona nga vende të ndryshme janë larguar dhe ofruar si luftëtarë lirie për Shtetin Islamik që nga krijimi i tij dhe rreth tre mijë prej tyre janë rikthyer në këto vende. Një fenomen i tillë ka prekur edhe Shqipërinë, prej të cilës janë larguar rreth 100 – 150 persona si luftëtarë në konfliktet e armatosura që po zhvillohen në Lindjen e Mesme, një pjesë e vogël e të cilëve janë rikthyer në atdhe. Gjithashtu, forcat e zbatimit të ligjit dhe ato të ruajtjes së rendit kanë zhvilluar disa aksione kundër celulave të cilat rekrutonin individë për t'i dërguar ato si luftëtarë lirie në konfliktet e armatosura që ndodhin në Lindjen e Mesme, disa prej të cilëve janë dënuar me vendime të formës së prerë.

Pavarësisht sa më sipër, një nga shkaqet e zhvillimit të fenomeneve të ekstremizmit, radikalizmit dhe terrorizmit, dhuna e vazhdueshme dhe diskriminimi, janë edhe më të theksuara në shoqërinë tonë, e cila njihet historikisht për tolerancën e saj fetare. Kështu, vetëm gjatë tre muajve të parë të vitit 2018 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka shqyrtuar dhe po shqyrton 38 raste të kërimit të urdhrave të mbrojtjes nga persona të ndryshëm, ndërsa raste dhune në familje janë më tepër së 130 duke u gjykuar në

procese penale gjatë të njëjtës kohë. Shifra të tilla tregojnë se përtej fasadës së qetë dhe tolerante, ekziston një realitet i dhunshëm brenda shoqërisë shqiptare, i cili manifestohet edhe në kuadër të familjes shqiptare, jo vetëm në qarkun e Tiranës, por në çdo qark tjetër, përfshirë atë të Fierit dhe për këtë shkak organet përkatëse duhet të realizojnë një fushatë të qenësishme sensibilizuese kundër fenomenit dhe të ndërmarrin hapat e referuar më poshtë në këtë Raport për kundërshtimin e tij.

8. AKTET NDËRKOMBËTARE DHE LEGJISLACIONI NË FUQI

Legjislacioni kundër terrorizmit përbëhet nga aktet ndërkombëtare në nivel të Organizatës së Kombeve të Bashkuar, nga ato të Këshillit të Europës, akte të tjera në nivelin e BE si Direktiva, Rekomandime apo Vendime Kuadër si dhe legjislacioni ynë i brendshëm i përshtatur me to. Janë gjithsej 18 konventave dhe protokolleve ndërkombëtare të miratuara nga Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB) apo agjencitë e saj. Një nga aktet më të hershme është Konventa e Organizatës së Kombeve të Bashkuara “Për luftën kundër financimit të terrorizmit”, e vitit 1999.⁵ Akt i rëndësishëm ndërkombëtar është Konventa Europiane “Për shtypjen e terrorizmit”⁶. Nga ana e Organizatës së Kombeve të Bashkuara janë miratuar rezoluta që japin kuptimin e terrorizmit, të cilat po i rendisim më poshtë.

- a. Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, me nr. 1373 (viti 2001) që përcakton si një detyrim ligjor për të gjitha shtetet krijimin e kuadrit të përshtatshëm ligjor, rregullator dhe institucional, duke përfshirë edhe: •
- b. Rezoluta nr. 1456 (viti 2003) e Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe rezolutat që vijuan më pas detyrojnë shtetet të garantojnë që çdo masë e marrë në luftën kundër terrorizmit të jetë në përputhje me jurisprudencën ndërkombëtare, në mënyrë të veçantë me jurisprudencën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, ligjin për refugjatët dhe ligjin humanitar.
- c. Rezoluta nr. 1566 (viti 2004) e cila përpiket të përkufizojë terrorizmin duke përdorur kritere të tilla si synimi, sjellja etj.

Përpos nënshkrimit të akteve sa sipër Shqipëria është bashkësponsorizuese e Rezolutës 2178 (2014) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Rezoluta e Këshillit të Sigurimit nr. 2178 “Mbi shkëmbimin e të dhënave mbi personat e dyshuar për pjesëmarrje në aktivitete terroriste” detyron shtetet anëtarë të OKB që të shkëmbejnë informacionet në mes të tyre në lidhje me personat e dyshuar për pjesëmarrje në aktivitete terroriste. Në zbatim të saj shteti shqiptar jep informacione

⁵ E ratifikuar nga vendi ynë me anë të ligjit nr. 8865 datë 14.03.2002 “Për ratifikimin e Konventës për luftën kundër financimit të terrorizmit,,

⁶ Ligji nr. 8642 datë 13.07.2000 „për ratifikimin e Konventës Europiane „Për shtypjen e terrorizmit“ dhe protokollat shtesë të saj.

- Kryerjen e veprimeve me persona të cilët janë shpallur si persona ndaj të cilëve zbatohen masat kundër financimit të terrorizmit,
- Veprimet që konsistojnë në rekrutimin e personave për të kryer akte terroriste
- Stërvitjen për kryerjen e akteve terroriste,
- Nxitjen, thirrjen publike dhe propagandën për kryerjen e veprave me qëllime terroriste
- Kanosjen për kryerjen e veprimeve terroriste etj.

Kodi ynë penal dënon ashpër kryerjen e veprimeve me qëllime terroriste¹⁰ të cilat kryhen duke shkatërruar, dëmtuar, destabilizuar institucionet shtetërore nëpërmjet akteve të dhunshme të përdorimit të armëve e lëndëve shpërthyesë, shkatërruar mjetet e transportit publik, mjetet fluturuese vrasje apo rrëmbim personi me qëllim shkaktimin e panikut, shkatërrimin me lëndë plasëse të çdo prone publike etj. për të përfshirë krime me natyrë terroriste me qëllim përhapjen e panikut në popullsi, shkatërrimin ose destabilizimin e strukturave themelore politike, kushtetuese, ekonomike ose shoqërore të shtetit shqiptar, të tilla si: i) rrëmbimi i personave; ii) dëmtimi serioz i pronës publike, infrastrukturës, sistemit të transporteve, sistemeve informatike, rrëmbimi i avionëve, anijeve ose mjeteve të tjera të transportit; iii) prodhimi, blerja ose zotërimi i lëndëve shpërthyesë, armëve biologjike, kimike, bërthamore, apo kërkimet për këto armë të shkatërrimit në masë etj.

Në vitin 2007 janë bërë disa ndryshime të tjera të Kodit Penal (në Nenin 231) për të reflektuar detyrimet e vendit me ratifikimin e Konventës të Këshillit të Evropës për Parandalimin e Terrorizmit, duke dënuar edhe: “*rekrutimin e individëve me qëllim kryerjen e akteve terroriste ose financimin e akteve terroriste, edhe kur këto akte drejtohen kundër një shteti, institucioni ose organizate tjetër ndërkombëtare [...]*”. Edhe nenet pasuese të Kodit Penal shqiptar trajtojnë gjerësisht problematikat e ndryshme juridike të terrorizmit, si Nenet 6, 7, 232 (a/b), 233 dhe 234.

Ndërkohë, legjislacioni penal (*Kodi i Procedurave Penale*) nuk parashikon procedura të posaçme hetimore për rastet e terrorizmit, ndonëse ka dispozita të posaçme për konfiskimin e pasurive, për shkak të angazhimeve ndërkombëtare që ka marrë Shqipëria në përpunje me Rezolutat 1267 dhe 1373 të Këshillit të Sigurisë të OKB-së. Në vitin 2013 Parlamenti Shqiptar miratoi ligjin nr. 157 datë 10.10.2013 për “*Masat kundër financimit të terrorizmit*”.

Tashmë ligji ynë penal, sikurse dhe ligjet e tjera bashkëkohore dënon dhe cilëson si vepër penale pjesëmarrjen në veprime luftarake në një shtet tjetër në një konflikt të armatosur ose pjesëmarrjen në çdo lloj trajnimit të zhvilluar nga struktura ushtarake, pa qenë shtetas në shtetin e huaj dhe pa qenë pjesëtar i forcave të armatosura të njëjës

¹⁰ Nenet 230 deri 234/b të KP

prej forcave ushtarake në konflikt.¹¹ Kjo quhet figura e veprës penale e “Pjesëmarrjes në veprime luftarake në një shtet të huaj”¹², Neni 265/a i KP.

Gjithashtu ligji ndëshkon veprimet që kanë të bëjnë me nxitjen, rekrutimin, organizimin, drejtimin, stërvitjen, vënien në dispozicion të pajisjeve, krijimin ose përdorimin e fondeve ose mjeteve të tjera për financimin, mbështetjen materiale të personave, në çdo lloj forme dhe mënyre, për të kryer veprën penale të pjesëmarrjes në veprime luftarake jashtë shtetit si dhe thirrja në mënyrë publike me çdo lloj forme, mjete dhe mënyre për të kryer veprën penale të parashikuar nga neni 265/a ose 265/b.¹³ Neni 265/b *Organizimi për pjesëmarrje në veprime luftarake në një shtet të huaj*. Neni 265/c *Thirrja për pjesëmarrje në veprime luftarake të dhunshme në një shtet të huaj*¹⁴

Më këto ligje synohet të parandalohet dhe të ndëshkohet fenomeni i largimit të shtetasve shqiptarë për të ndihmuar grupet kriminale e terroriste që luftonin në konfliktin e armatosur në Siri e Irak si ISIS.

9. JURISPUDENCA SHIQPËTARE DHE BOTËRORE. SHEMBUJ TË PRAKTIKËS GJYQSORE MBI VEPRAT PENALE TË KRYERA NGA RADIKALË DHE EKSTREMISTË

Jurisprudenca botërore e lidh kuptimin e ekstremizmit të dhunshëm me terrorizmin. Ekstremizmi e radikalizmi kanë si pasojë dhunën e terrorizmin. Terrorizmi është një ndër krimet e rënda. Ai nuk mund dhe nuk duhet të lidhet në asnjë mënyrë me ndonjë kombësi, përkatësi fetare apo etnike. Ndonëse në jurisprudencën ndërkombëtare nuk gjen ndonjë përkufizim të pranuar botërisht për sa i përket terrorizmit, për ta etiketuar një akt si “terrorizëm” do të thotë të vërtetosh jo vetëm që ai mbart disa karakteristika, por gjithashtu që nuk mund të përligjet nga asnjë konsideratë politike, filozofike, ideologjike, racore, etnike apo fetare.

Ndaj edhe përcaktimi i një përkufizimi të saktë mbi terrorizmin përbën një element me shumë rëndësi në luftën me sukses kundër terrorizmit, duke garantuar përputhshmëri me sundimin e shtetit ligjor dhe me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

¹² Pjesëmarrja në formacione luftarake, organizata ushtarake ose paraushtarake në një konflikt të armatosur që zhvillohet në territorin e një shteti të huaj ose pjesëmarrja në çdo lloj trajnimit të zhvilluar nga këto struktura, pa qenë shtetas në shtetin e huaj, pa qenë pjesëtar i forcave të armatosura të një shteti të huaj në konflikt ose misioneve ushtarake zyrtare të forcave të armatosura të një shteti që nuk është palë në konflikt ose misioneve ushtarake zyrtare të një organizate ndërkombëtare, dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet. Kur kjo vepër penale kryhet me qëllim përmbysjen e rendit kushtetues ose shkeljen e integritetit territorial të një shteti të huaj, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.

¹³ Këto u shtuan me ligjin nr. 98/2014 datë 31.07.2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895 datë 27.01.1995 “Kodi Penal i RSH ,

¹⁴ Thirrja në mënyrë publike me çdo lloj forme, mjete dhe mënyre për të kryer veprën penale të parashikuar nga neni 265/a ose 265/b, dënohet me burgim deri në tre vjet “

Terrorizmi ndodh në shumë kontekste të ndryshme dhe shpaloet në po aq forma. Pa u përpjekur të përkufizojmë terrorizmin, ndër karakteristikat e zakonshme të tij zakonisht përfshihen rreziku për jetën, gjymtimin apo pronën, një përpjekje për minimin e qëllimshëm të qeverisë demokratike, kryesisht përmes përpjekjeve për ndikimin e politikave dhe hartuesve të ligjeve, një përjasje pa dallim ndaj përzgjedhjes së objektivave, me qëllim mbjelljen e frikës dhe terrorit në popullatë.

Aktet terroriste janë veprime kriminale dhe rrjedhimisht, janë pjesë e tagrit të sistemit të drejtësisë penale. Standardet e të drejtave të njeriut do të zbatohen pavarësisht nëse një incident i caktuar konsiderohet si akt terrorist apo një vepër tjetër që hyn në kategorinë e krimeve të rënda. Një zgjidhje në lidhje me vështirësinë për përkufizimin e terrorizmit mund të jetë përqendrimi tek parandalimi dhe/ose ndëshkimi i sjelljeve me natyrë të mirëfilltë terroriste. Ndonëse ende bashkësia ndërkombëtare nuk ka mundur të gjejë konsensus mbi definicionin e terrorizmit, është rënë dakord që disa akte përbëjnë akte terroriste.

“*Terrorizmi*” dhe krimet që lidhen me të gjejnë shprehje të qartë në legjislacionin vendas, me saktësi, në mënyrë jodiskriminuese dhe pa prapaveprim. Ligjet dhe rregulloret përkatëse duhet të vihen në dispozicion të publikut të gjerë dhe duhet të zbatohen me përpikëri dhe transparencë nga autoritetet publike, duke përfshirë policinë dhe gjyqësorin. Kjo do të përbënte një parakusht që njerëzit ta kuptonin ligjin dhe rrjedhimisht, ta përshtatin sjelljen e tyre. Kjo është po kaq e rëndësishme për sigurimin e bazës për veprime efikase dhe të përgjegjshme kundër terrorizmit, duke përfshirë veprimet e ndërmarra nga policia, në përputhje me veprimin e shtetit ligjor dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Lufta kundër ekstremizmit të dhunshëm, radikalizmit dhe pasojës së tyre terrorizmit është e mbushur me shembuj të përpjekjeve të organeve ligjzbatuese, forcave përparimtare të shoqërive perëndimore e atyre në zhvillim me qëllim parandalimin dhe tyre. Pas ngjarjeve të 11 Shtatorit 2001 në New York, SHBA dhe Luftës Kundër Terrorizmit që i pasoi ato, ndërhyrjes në Irak, konflikteve në mes të palestinezëve e izraelitëve dhe së fundmi konflikti i armatosur në Lindjen e Mesme, Siri e Irak kanë nxitur një valë të radikalizimit të qytetarëve në Ballkanin Perëndimor, Europë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës , Azi , Afrikën Veriore e etj.

Radikalizmi dhe eskremizmi i dhunshëm janë shndërruar në instrumente të rrezikut për paqen në rajon, atë botërore e në një përplasje të fortë në mes të së mirës e së keqes, forcave progresive të shoqërive perëndimore e atyre të errëta që kryesisht e kanë nxitjen e financimin nga Lindja e Mesme, vendet e gjirit Arabik e Afrika Veriore. Shoqëria shqiptare si gjithë vendet e rajonit si Bosnjë Hercegovina, Kosova , Maqedonia janë prekur nga ndikimi i këtij konflikti global.¹⁵

Shqipëria u infektua nga ky fenomen për shkak të ndikimit që patën në shoqërinë shqiptare rrymat e grupet radikaliste jashtë strukturave të besimit

¹⁵ “*The Coming Balkan Khalifate : The Threat of Radical Islam to Europe and the East*” Christofer Deliso

tradicional mysliman dhe institucioneve të komunitetit mysliman shqiptar. Anëtarësimi i Shqipërisë në Konferencën Islamike u dha mundësinë individëve radikalë e ekstremiste, organizatave radikale e atyre me orientim fundamentalist islamik e vehabist që duke shfrytëzuar vakuomet institucionale e ligjore, varfërinë e mungesën e zhvillimit në zonat e prapambetura të vendit, ato që kryesisht i përkisnin besimit të kultivuar e të ushtruar mysliman, që të shtrinin ndikimin e tyre duke radikalizuar një grup të konsiderueshëm qytetarësh shqiptarë. Kjo, fillimisht nëpërmjet indoktrinimit të tyre e dërgimit për studime shkolla e universitete teologjike të ideve ekstremiste në vendet e Gjirit Arabik, Turqi e pastaj me kthimin e tyre në Shqipëri e përhapjen e elementeve teologjike ekstremiste.¹⁶

Lufta e armatosur në Siri dhe sjellja e pushtetit të Presidentit Bashar Al Asad ndaj popullsisë siriane dhe kryengritësve atje, solli një përkrahje dhe solidaritet në mbarë botën me atë pjesë të popullsisë e forcave të armatosura duke nxitur një lëvizje të tërë globale e duke inkurajuar forcat ekstremiste e mbetjet e Al Quedas në bashkimin e tyre. Ata arritën të mbledhin pas vetes mijëra përkrahës, dhe nga vendet europiane e ato ballkanike sidomos, pas proklamimit të krijimit të ashtuquajturit Shtetit Islamik (ISIS). Grupet ekstremiste nëpërmjet individëve të shkolluar në vendet arabe si Arabi Saudite, Jemen, Jordani, Siri, por dhe në Iran, Turqi etj. rekrutojnë qytetarë shqiptarë duke bërë të mundur përhapjen e ideve të tyre ekstremiste, radikale dhe dërgimin në Siri e Irak duke u përfshirë në konfliktin e armatosur atje, fillimisht, në krah të organizatës terroriste Jabah Al Nusra e më pas në ISIS.¹⁷

Më poshtë po sjellim disa shembuj të praktikës hetimore e gjyqësore të rasteve të sjelljeve e veprimeve radikale e ekstremiste të disa shtetasve, procese të zhvilluara në Gjykatën e Krimeve të Rënda.

Rasti praktik 1. *(çështja e Imamëve të vetëshpallur të xhamive në Tiranë e Mëzez, që arritën të dërgonin shtetas shqiptarë në Siri).*

Gjatë viteve 2012 – 2014, disa persona të cilët kishin studiuar në universitete teologjike fetare në Medina, Arabi Saudite dhe Bursa, Turqi e konkretisht shtetasit G.B, B.H dhe G. P, A. D, kishin arritur të krijonin disa struktura fetare në formën e objekteve të kultit dhe edukimit teologjik jashtë strukturave zyrtare të Komunitetit Mysliman Shqiptar, konkretisht në Tiranë, në xhamitë pranw Unazës së Re dhe të Mëzesit, në Cërrik, Elbasan¹⁸ dhe në Leshnicë, Pogradec. Këto persona të

¹⁶ Raporti i Departamentit Amerika të Shtetit për Luftën kundër Terrorizmit, 2014.

¹⁷ Afërsisht 150 shtetas shqiptarë janë kanë shkuar në Siri me qëllim angazhimin dhe ndihmën ndaj grupeve të armatosura atje, ndër të cilët 31 fëmijë dhe 13 gra.

¹⁸ Ndërtesa në Cërrik ku shtronte veprimtarinë e tij predikuese imami G. P ishte një vend i përshtatur i quajtur Musala.

vetëshpallur imamë ishin predikues të rrymave fetare ekstremiste e radikale e konkretisht atyre salafiste¹⁹ e tekfiriste²⁰ rryma derivative të vehabizmit arabik.²¹

Ata kishin arritur që në bashkëpunim me një grup personash të tjerë ekstremistë radikalë bashkëpunëtorë të tyre, gjithsej 9 persona kishin krijuar struktura të tëra që mbështetnin e predikonin ide radikale ekstremiste, nxisnin urrejtje fetare e racore si dhe promovonin ligjin e Sheriatit edhe në Shqipëri, si dhe xhihadin luftarak në Siri, Irak (*siç e quanin ato tokën e Shenjtë të Shamit e Levantes*) për llogari të organizatës terroriste Xhehbetul Al Nussra (Jabhat Al Nussra)

Ato nëpërmjet shkrimeve kompjuterike arritën të shprehnin përkrahjen ndaj sulmeve terroriste në Paris. Në ambientet e xhamisë predikonin ide radikale e nxisnin urrejtjen fetare e racore tek një grup fëmijësh që kishin braktisur shkollat dhe frekuentonin këto ambiente si shkolla dhe konvikte. Në predikimet e tyre ato nxitnin kryerjen e veprimeve terroriste ndaj jobesimtarëve, amerikanëve, hebrenjve si dhe ndaj drejtuesve të komunitetit mysliman shqiptar.

Këto persona në bashkëpunim më të tjerët si O. R, F. M, V, M, Z. Y, E. B, në kuadër të veprimtarive propagandistike dhe nxitëse arritën të rekrutojnë e të dërgojnë në Siri për të luftuar e ndihmuar grupet terroriste, , shtetas shqiptare ndër të cilët disa gra e fëmijë. Këto persona u ndaluan në vitin 2014. Në banesat e tyre u gjetën , materiale të ndaluara ekstremiste fetare si dhe në banesën e njërit prej tyre Z.Q, u gjetën edhe armë e lëndë plasëse.

Ato u akuzuan nga Prokuroria për Krime të Rënda për veprat penale të *"Nxitjes, thirrjes publike dhe propagandës për kryerjen e veprave terroriste"* , neni 232 e 25 i KP, *" Nxitjes e urrejtjes e grindjes "*, neni 265 e 25 i Kp si dhe veprën penale të *"Rekrutimit të personave për kryerjen e veprave penale me qëllime terroriste ose të financimit të terrorizmit "* , neni 231 e 25 e KP.

Ato u gjykuan në Gjykatën e Krimeve të Rënda për këto vepra dhe u gjetën fajtorë për to, duke u dënuar konkretisht, për kryerjen e veprave penale të *"Nxitjes, thirrjes publike dhe propagandës për kryerjen e veprave terroriste"* , neni 232 e 25 i KP, *"Nxitjes e urrejtjes e grindjes "*, neni 265 e 25 i Kp, si dhe veprën penale të *"Rekrutimit të personave për kryerjen e veprave penale me qëllime terroriste ose të financimit të terrorizmit "* , neni 231 e 25 e KP.²²

¹⁹ Tekfir / Tekfirizëm është tendenca e shfaqur tek disa formacione selafiste – xhihadiste për të bashkuar deklarin dhe veprimet dikujt si jo – islame. Misioni e tekfirizmit është të rikrijë kalifatit sipas interpretimit fjalë për fjalë të Kuranit

²⁰ Selef, Selefizëm: përshkruan një person, grup apo besimin brenda Islamit që përqendrohet në imitimin e gjeneratave të hershme të myslimanëve ("*Selefët*") dhe restaurimin e fesë të pastër. Shumica e selefive nuk janë të dhunshëm, dhe shumica i shmangen angazhimit politik të çdo lloji, ndërsa, disa janë politikisht aktiv. Një pakicë e selefive janë ekstremistë të dhunshëm apo xhihadistë

²¹ Vehabizmi është një lëvizje fetare e Islamit Sunit e përshkruar ndryshe dhe si ultrakonservative, e rreptë, fundamentalist kryesisht e përhapur në Arabinë Saudite, Jemen etj.

²² Vendimi nr. 58 datë 03.05.2016 i Gjykatës së Shkallës së Për për Krime të Rënda.

Rasti praktik 2. (Çështja e të pandehurit A. D, një nga drejtuesit e një grupi të grupit terrorist ISIS) I pandehuri {A D} nga viti 2008 deri pas muajit nëntor 2010 ka qenë imam i Xhamisë së fshatit L, P. Pas festës së Bajramit të vitit 2010, i pandehuri {A D} është larguar nga kjo punë me motivacionin ”Thyerje të statusit dhe rregullave të brendshme të Komunitetit Mysliman”. Konkretisht, ka refuzuar faljen e Bajramit ditën e caktuar nga Komuniteti Mysliman Shqiptar, pra, në ditën e festës zyrtare të parashikuar si të tillë në kalendarin islamik. Gjatë ushtrimit të kësaj detyre, por dhe më pas, ai ka predikuar nevojën për të përkrahur dhe ndihmuar grupet e shpallura terroriste që luftonin në Siri, kundër regjimit të Bashar Al Assad.

Duke përfutur nga devotshmëria fetare, ka arritur të bindë dhe të rekrutojë, për të marrë pjesë në këto luftime, shtetasin {E A}. Bashkë me të është larguar drejt Sirisë, duke dalë nga territori i Shqipërisë nëpërmjet aeroportit Rinas më datë 08.02.2013, për t’iu bashkuar grupeve terroriste që luftonin regjimin e Bashar Al Assad. Ka të dhëna se shtetasi {E A} është vrarë gjatë këtyre luftimeve. Gjithashtu, i pandehuri {A D} ka marrë dhe merr pjesë në luftimet e grupeve terroriste që luftojnë këtë regjim, në bashkëpunim dhe me shumë persona të tjerë.

I pandehuri {A D}, duke qenë pjesëmarrës i luftimeve në Siri, ka siguruar personat që do t’i prisnin dhe më tej t’i bashkonin me grupin e duhur në Siri, shtetasit {M K}, {E D}, {B V}, larguar nga Shqipëria më datë 06.01.2014, rekrutim ky i organizuar në Shqipëri nga i dënuari {B H}, ndihmuar nga i dënuari {V M}. I pandehuri A është vënë në dijeni, paraprakisht, nëpërmjet komunikimit telefonik nga i bashkëpandehuri/i dënuari {B H}, imam i xhamisë U.R dhe M(së bashku me të dënuarin {G B}), të paktën disa ditë para nisjes së këtyre shtetasve dhe me mbërritjen e tyre, ka organizuar pritjen nga persona të besuar, duke ia ka njoftuar këtë fakt bashkëpunëtorit/të dënuarit {B H}. Shtetasit {M K}, {E D}, {B V}, kanë marrë pjesë në stërvitje apo në veprime luftarake dhe janë kthyer në Shqipëri më datë 12.05.2014.

Rezulton se gjatë qëndrimit në Siri dhe pjesëmarrjes në luftimet që zhvillohen atje në përbërje të grupimeve që luftonin regjimin e Bashar Al Assad, i pandehuri {A D} ka mbajtur kontakte të vazhdueshme me disa prej të dënuarve si organizatorë të një veprimtarie të gjerë rekrutuese, {B H}, {G P}. Gjithashtu, ka mbajtur kontakte dhe me persona të tjerë, shtetas shqiptarë, të cilët interesoheshin për familjarët e tyre të gjendur në Siri dhe luftonin në këto grupe kundër regjimit të Bashar Al Assad, apo dhe që ishin vrarë në këto luftime. Ai i ka vënë në dijeni për gjendjen e luftimeve, gjendjen e shtetasve shqiptarë që luftonin atje, ka përcjellë lajme se çfarë do të bëhej më të afërmit e të vrarëve të gjendur në Siri dhe këtë e ka bërë, si nëpërmjet komunikimeve telefonike, ashtu dhe nëpërmjet komunikimeve në rrjete sociale.

I pandehuri {A D}, në bashkëpunim dhe me persona të tjerë, si pjesëmarrës në këto luftime, nëpërmjet seksionit të medieve të shtetit të vetëquajtur i Irakut dhe Sirisë (të ashtuquajturit ISIS, aktualisht IS), nëpërmjet rrjeteve sociale, ka bërë thirrje publike me përmbajtje të tillë që nxit urrejtjen dhe grindjet për shkak të fesë, duke

përkrahur luftën që po bëjnë grupimet, përfshirë dhe Xhehbetul Al Nussra (Jabhat Al Nussra), kundër regjimi i Bashar Al Assad në Siri.

Për këto fakte e akuza ai u gjykua në Gjykatën e Krimeve të Rënda dhe u deklaruar fajtor për veprën penale *“Rekrutimi i personave për kryerjen e veprave penale për qëllime terroriste ose të financimit të terrorizmit”* kryer në bashkëpunim, për veprën penale *“Nxitja e urrejtjes ose e grindjeve”* kryer në bashkëpunim, për veprën penale *“Pjesëmarrje në veprime luftarake në një shtet të huaj”* kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 265/a/1 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal.²³

Rasti praktik 3. (*Çështja e shtetasit të radikalizuar P.C i cili kundrejt veprimeve ekstremiste tentoi të vriste dhe babanë e tij*) Shtetasi P. C nga qyteti i Korçës megjithëse nga një familje qytetare korçare e besimit ortodoks ishte konvertuar në besimin islam të rrymës vehabiste gjatë kohës që ndiqte studimet në kolegjin George Brown, Kanada. Me tu kthyer në qytetin e Korçës ai u vendos në kontakt me një grup shokësh të tij nga qytetet Korçë e Pogradec shtetasit E. M, A. Z, A, Sh. E. F. Këta shtetas ishin persona të radikalizuar dhe frekuentues të faqeve të web të grupeve ekstremiste e terroriste islamike, gjithashtu të gjithë predikues të xhihadit luftarak në Siri, nxitës të urrejtjes dhe ushtrimit të dhunës ndaj besimeve të tjera, mbështetës të organizatës terroriste ISIS dhe predikues të ideve radikale e terroriste të saj e në të njëjtën kohë, edhe përdorues të lëndëve narkotike.

Ky grup u akuzua për veprat penale të *“Pengimit të veprimtarive fetare”*, neni 132, *“Shkatërrimi i objekteve”*, *“Nxitjes së urrejtjes fetare”* neni 265 të KP. P.C nuk pranoi të merrte pjesë në ceremoninë e varrimit të nënës së tij L. C sipas riteve të besimit ortodoks. Për këto e konflikte të tjera ai më datën 5.12.2016 ka tentuar të vrasë babanë e tij M. C. Avokat i njohur në qytetin e Korçës. Për këtë ai është akuzuar për veprën penale të *“Vrasjes për shkak të marrëdhënieve familjare”*, neni 79/c i KP.²⁴

Rasti praktik 4. (*çështja e të miturit nga Lushnja, i cili u rekrutua për të shkuar në Siri nga imami i xhamisë së fshatit të tij dhe një shtetas sirian*) J. Q ishte një i mitur i lindur dhe banues në fshatin G Lushnjë. Në vitin 2015 me datën 22.04.2015 ai u depërtua nga autoritetet greke në Shqipëri dhe gjatë intervistimit të tij ai deklaroi se qëllimi i kalimit në Greqi kishte qenë ikja në Siri me qëllim për të luftuar atje, kundrejt një shpërblimi prej 200 mijë eurosh që i kishin ofruar dy shtetas shqiptarë dhe një sirian. Ai ishte kontaktuar nga imami i xhamisë së fshatit të tij, M.M dhe imami i xhamisë pranë Fierit T. B. si dhe personi nga Siria me emrin A. Ai

²³ Vendimi nr. 46 datë 04.05.2017 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

²⁴ Vendimi nr. 1 datë 24.01.2018 *“Për dërgimin e çështjes në gjyq”* i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda“

është shoqëruar për në Greqi nga këta persona. Ndaj këtij shtetasi, Prokuroria ngriti akuzën e “Pjesëmarrjes në veprime luftarake në një shtet të huaj “ neni 265/a i KP.²⁵

Rasti praktik 5. (Çështja e shtetasit të radikalizuar kosovar i cili kreu veprime terrori ndaj 3 shtetasve shqiptarë në Vlorë) Shtetasi D. XH. Ishte shtetas kosovar, i cili kishte ardhur për pushime në Jug të Shqipërisë gjatë periudhës së gushtit 2016. Në datën 16.08.2016 ai ka tentuar të rrëmbejë shtetasen B.M nëpërmjet veprimeve të dhunshme e duke përdorur shprehje arabisht. Gjithashtu ai ka përdorur dhunë dhe veprime force goditje dhe kërcënime ndaj shtetasve N. M dhe F. D, duke i goditur me grushte e duke i ndjekur në ambientet e brendshme të një lokali, veprime këto të shoqëruara me shprehje “Allahu Ekber “ e shprehje të tjera arabisht. Pas arrestimit nga ana e policisë ai ka kërcënuar punonjësit e policisë “në emër të Allahut”. Për këto veprime ky shtetas është akuzuar për veprat penale të “Vepra me qëllime terroriste “ “Kundërshtim i punonjësit të policisë “ nenet 230/g dhe 236 të KP.²⁶

Format e shfaqjes së ekstremizmit nuk janë vetëm ato me karakter ideologjik e fetar, por dhe ato që lidhen me krimin në familje, rrëmbimin, dhunën me pasojë jetën, gjobvëniet e mundshme. Pra, vepra penale që gjenerohen nga sjelljet ekstremiste.

10. MËSIMET NGA PËRVOJA. SI MUND TË NDIKOHEN TË RINJTË DHE NXËNËSIT NGA EKSTREMIZMI E RADIKALIZMI

Kur ideologjitë ekstreme nguliten me mendjet e të rinjve ato shndërrohen në veprime të dhunshme radikale që krijojnë problem në shkollë, shoqërinë e komunitetin ku jetojnë. Gjatë viteve 2013- 2015 edhe në Shqipëri u vu re fenomeni i përfshirjes së fëmijëve, nxënësve dhe të rinjve në veprimet ekstremiste dhe radikale, sigurisht të nxitur nga të rriturit. Kështu, një numër i konsiderueshëm fëmijësh dhe nxënës të shkollave merrnin pjesë dhe frekuentonin vende kulti të palicensuara, në të cilët, persona të vetëquajtur imamë përhapnin ide ekstremiste fetare e radikale duke nxitur urrejtjen fetare, racore e nacionale ndaj besimtarë tradicionale myslimanë shqiptarë dhe besimeve të tjera.

Gjithashtu një numër fëmijësh e të miturish u dërgua nga të rriturit viktimë të këtyre ideologjive për të ndihmuar të ashtuquajturën luftën e shenjtë në Siri dhe Irak. Sa i takon Shqipërisë, sipas burimeve zyrtare, të paktën 13 shtetas shqiptarë janë zhvendosur në Siri gjatë periudhës 2012-’14 bashkë me gratë dhe rreth 31 fëmijë. Një pjesë e fëmijëve kanë mbetur jetimë në Siri, pasi prindërit kanë humbur jetën në luftime. Referuar burimeve zyrtare, familjarët banojnë në shumicën e rasteve në kampe lufte, ndërsa baballarët luftojnë për grupet ekstremiste. Të paktën në një rast,

²⁵ Vendimi nr. 188 datë 25.04.2015 i Gjykatës së Shkallës Parë për Krime të Rënda.

²⁶ Vendimi nr. 8 datë 06.02.2017 i Gjykatës së Shkallës së Pastre për Krime të Rënda

një xhihadist që ishte në përgjim nga SHISH dhe Prokuroria, ka marrë në Siri fëmijët e tij pa pëlqimin e nënës së tyre.

Një proces gjyqësor i zhvilluar në Gjykatën e Krimeve të Rënda ndaj shtetasve G. P, G. B, B.H etj., të ashtuquajtur imamë, e të akuzuar për nxitje të urrejtjes raciale, fetare, si dhe rekrutim të personave për të marrë pjesë në akte terroriste evidentoi këtë fenomen të rrezikshëm, i cili ishte shtrirë kryesisht në zonat e Tiranës, Kavajës, Dibrës, Librazhdit dhe Pogradecit.²⁷

Përvoja na mëson se fëmijët, nxënësit e të rinjtë janë targeti më i manipulueshëm nga ekstremistët sidomos në rastet kur familjarët e tyre, të afërmit e rritur janë të tillë. Zhvillimi i formave të komunikimit social, rrjetet sociale, aksesit i pakufizuar në to, janë një mundësi për të rekrutuar të rinjtë. Gjatë një procesi penal të zhvilluar në Gjykatën e Krimeve të Rënda rezultoi se të pandehurit ekstremistë të ideve radikale kishin shumë frekuentues të rregullt në faqen e tyre të web rreth 1500 vetë, shumica e të cilëve ishin të rinj.

FAKTORËT TËRHEQËS

Faktorët tërheqës të cilët mund të tërheqin nxënësit dhe të rinjtë në përqafimin e ideve ekstremiste dhe fetare janë mungesa e formimit të mirëfilltë moral e qytetar, por dhe shkencor si mosfrekuentimi i duhur i shkollës e ambienteve shoqërore të shëndosha, referimi në modelet e gabuara të njerëzve të dhunës e forcës, etj.

Procesi i radikalizmit zakonisht fillon me rritjen e vetëdijesimit të një personi për një identitet politik ose social, i cili shpesh shkaktohet nga ndonjë ngjarje ose nga ndonjë grup i jashtëm. Kjo mund të shkaktojë që ata të shohin botën si të ndarë në grupe konkurruese (grupit të vet dhe grupeve tjera që mund të jenë armiqtësore ndaj tij). Ky proces është shumë i zakonshëm në mbarë botën, por që sigurisht nuk nënkupton që automatikisht të rezultojë në radikalizëm të dhunshëm. Dikush që identifikon shumë veten me grupin e vet mund të bëhet pjesë e një komuniteti protestues politik, organizate apo lëvizje, e cila është ende jo e dhunshme dhe përdor forma legjitime të protestës për të sjellë ndryshime në politikën e qeverisë për të adresuar ankesat. Kërkohet diçka më shumë që ajo të shndërrohet në dhunë. Mund të jenë faktorë të ndryshme të cilët mund të shtyjnë që ajo të shndërrohen në dhunë, duke filluar nga një ndjenja se protesta politike është e paefektshme, rritja e "zemërimit moral" në një veprim të kryer nga një grup tjetër, ose shkak mund të jetë diçka që ndërlidhet me psikologjinë ekstremiste.

Të rinjtë, veçanërisht djemtë e rinjtë, nxënësit e shkollave, por dhe ato që nuk i frekuentojnë rregullisht shkollat janë grupi më i lartë që rrezikohen nga ekstremizmi dhe dhuna e të gjitha llojeve. Ata janë në faza tranzicionale në jetën e tyre, si nxënës, të formimit të personalitetit. Disa nga ekstremistët e dhunshëm janë të motivuar nga dëshira për të qenë të rëndësishme dhe të luajnë një rol në diçka të rëndësishme. Kjo

²⁷ Vendimi nr. 58 datë 3.05.2016 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

ndodh tek ata që nuk shohin rrugë tjera për një jetë kuptimplotë, ose ndjejnë se nuk kanë interes apo rol për të luajtur në shoqëritë e tyre. Lidhjet personale janë gjithashtu shumë të rëndësishme për përhapjen e procesit të radikalizimit. Shumica e rekrutëve të ISIS apo Al Kaedës e kanë bërë këtë përmes miqve, dhe shumica e pjesës tjetër përmes familjes ose personave të tjerë që janë në kërkim të një rrugë domethënëse në jetë.

Prandaj mund të themi se ekzistojnë një numër motivesh tashmë të njohura që ndikojnë, si:

- Personaliteti i nxënësit apo i të riut, formimi i tij i gjithanshëm kulturor, moral e shkencor;
- Mjedisi shoqëror e familjar;
- Mungesa e ndikimit të shkollës dhe krijimit të lidhjeve të forta edukative të saj me nxënësin;
- Motivimi ideologjik dhe fetar;
- Dëshira për aventure dhe shpirt për lidhshëm;
- Mospërmbushja e ambientit socio- kulturor;
- Grupet e marxhinalizuara dhe distancë nga shoqëria.

Prandaj, me gjithë përpjekjet e institucioneve shtetërore që të adresojnë të gjitha këto sfida, kryesisht ekonomike dhe sociale, ende krijohet ambient për zhvillim të faktorëve që shpien në ekstremizëm të dhunshëm, duke iu lënë hapësirë grupeve me prirje radikale që lehtësisht t'a shfrytëzojnë situatën për të rekrutuar përkrahës për kauzën e tyre.

Në kohën kur interneti zë një vend të rëndësishëm në informimin e njerëzimit ka shumë mundësi që radikalizimi të bëhet online. Në botën e medieve sociale si: *You Tube, Skype dhe Facebook, Tweeter* dhe shumë rrjeteve të tjera, të cilat përdoren për komunikim të gjerë, rekrutimi dhe influencimi i pikëpamjeve të caktuara është i mundur. Për momentin, ISIS ka qenë efektive në ofrimin e hapësirave në Internet për të diskutuar dhe përsosur mesazhin e tyre, si dhe të kërkojë rekrutë në mënyrë efektive.

Komunitetet radikale apo ekstremiste mund të gjenden në *Twitter ose Facebook*, ku ofrojnë platforma efektive për të rekrutuar dhe drejtuar individët. Por, deri në çfarë mase kjo është efektive është e vështirë për t'u thënë. Sidoqoftë, radikalizimi në Internet shërben si një mjet për të mbështetur një proces radikalizimi që zhvillohet mes miqve dhe kontakteve personale me persona të panjohur që i bashkohen të njëjtës ideologji. Interneti është një mundësi për të nxitur karakterin e dhunshëm e kërcënues si në rastin e përdorimit të rrjeteve sociale për kërcënime, gjobvënie etj. Të rinjtë e nxënësit si përdorues të mirë të rrjeteve sociale e Internetit janë sigurisht grupi i personave që mund t'a përdorin më shpesh atë për qëllime agresive.

PARANDALIMI, ROLI I SHKOLLËS DHE KOMUNITETI

Shkolla ka një ndikim shumë të madh në formimin e nxënësve me njohuritë e nevojshme morale e shoqërore duke parandaluar ngulitjen dhe përhapjen e ideve ekstremiste e radikale. Krahas edukimit qytetar është e nevojshme që tashmë nxënësit të kenë njohuri për tema të tilla, si dhe në kuadër të diskutimit të këtyre fenomeneve me qëllim njohjen e tyre. Gjithashtu edukimi ligjor duhet të jetë më i plotë në shkollë në mënyrë që të bëhet dallimi mes sjelljes së lirë e asaj me pasojë në konflikt me ligjin. Shkollat, të cilat janë në zonat rurale apo zonat gjeografike ku ka të dhëna që vegjetojnë elemente radikalë, duhet të kenë një strategji të qartë reagimi të koordinuar me institucionet arsimore e ato vendore e të kultit.

Në sistemin tonë arsimor është promovuar nisma “*Shkolla si qendër komunitare si një shkollë miqësore për të gjithë*”.²⁸ Kjo nismë e përmendur dhe në kuadër të strategjisë së përgjithshme kombëtare inkurajon partneritetin mes shkollave, familjeve, komunitetit, duke i cilësuar ato jo vetëm si ofrues të procesit të arsimit, por dhe si ambiente ku diskutohen çështje të zhvillimeve të tjera ndër të cilët ato kundër kërcënimeve, ekstremizmit të dhunshëm duke ofruar shërbime, këshillime, me qëllim konceptimin e programeve parandaluese.

Mësuesit janë punonjës të rëndësishëm, të cilët shërbejnë dhe si ndërlidhës brenda komunitetit dhe prandaj përgjegjësia e tyre për t’iu kundërpërgjigjur radikalizmit është e madhe prandaj është e rëndësishme që nxënësit dhe të rinjtë të kenë njohuri të nevojshme për këto fenomene dhe mësuesit të trajnohen për t’i dalluar ato dhe për të reaguar ndaj shenjave të radikalizimit. Është e rëndësishme trajtimi i shkaqeve socialo-ekonomike që nxisin radikalizimin. Përmirësimi i kurrikulave mësimore në lidhje me njohuritë mbi ligjin dhe sjelljet në konflikt me ligjin.

Duke kuptuar fenomenin nxënësit duhet të krijojë aftësi në evidentimin e tij qoftë përpara mësuesve, psikologëve ose punonjësve të policisë. Policia e Shtetit ka modelin e policimit në komunitet që e zbaton në të gjithë vendin dhe në këto zona. Nxënësit duhet të jenë në kontakt dhe me punonjës të policisë për të evidentuar rastet e sjelljeve të dhunshme, radikale apo atyre ekstreme.

11. MJETET QENDRORE DHE VENDORE PËR LUFTIMIN E EKSTREMIZMIT DHE RADIKALIZMIT

Në lidhje me mjetet e ndryshme të cilat mund të përdoren si në nivelin lokal dhe atë qendror për të luftuar këto fenomene, konkretisht vlerësojmë se disa nga masat që mund të merren nga qeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë për parandalimin dhe luftën kundër fenomeneve të ekstremizmit të dhunshëm, radikalizmit dhe

²⁸ Nisma “*Shkolla si qendër komunitare si një shkollë miqësore për të gjithë*” që zbatohet nga Ministri i Arsimit.

terrorizmit dhe që në kushtet e mundësive financiare mund të realizohen realisht dhe praktikisht prej tyre janë:

- krijimi i një pozicioni të specializuar në bashki që të trajtojë të gjitha çështjet që lidhen me këtë problematikë;
- bashkëpunimi i vazhdueshëm me shoqërinë civile për identifikimin e rasteve konkrete dhe ndjekjen e tyre për sa është e mundur, përfshirë konsulencën ligjore dhe psikologjike ndaj tyre kur është e mundur;
- organizimi i fushatave sensibilizuese kundër dhunës, radikalizmit dhe terrorizmit. Fushatat mund të jenë të natyrave sensibilizuese të fenomenit, të tipareve pozitive të tolerancës, përfshirjes, respektit reciprok, konkurrencës së ndershme, etj.;
- realizimi i fushatave të bashkëpunimit dhe promovimit të punës, bashkëpunimit, aktivizimit dhe pjesëmarrjes së të rinjve në ambientin e përbashkët. Organizimi i aktiviteteve të përbashkëta kulturore, arsimore, sportive, ambientale, etj.;
- identifikimin e plotë e të saktë të personave në vështirësi ekonomike dhe aplikimin e saktë të sistemit të ndihmës sociale;
- identifikimin e personave të papunë dhe futjen e tyre në listën e punëkërkesve dhe krijimin e kushteve për trajnimin e tyre profesional;
- trajnimin profesional të të rinjve dhe realizimin projekteve me to;
- promovimi i sjelljeve të përgjegjshme dhe fushata sensibilizuese për shkurajimin e sjelljeve jo-qytetare, etj.

Për sa i përket masave që mund të ndërmerren pushteti qendror për parandalimin dhe kufizimin e këtij fenomeni, ndër to mund të përmendim:

- miratimi i akteve normative në luftë kundër fenomenit;
- rritja e bashkëpunimit me shtete të tjera dhe organizata ndërkombëtare për të shkëmbyer informacion dhe eksperiencë në luftë kundër fenomenit;
- bashkëpunimi me organet e qeverisjes vendore dhe shoqërinë civile dhe organizatat fetare për luftimin e fenomenit;
- identifikimin e problematikave dhe zonave problematike në lidhje me vështirësitë ekonomike dhe sociale;
- krijimin e politikave sociale dhe ekonomike dhe nxitjen e bashkëpunimit, tolerancës dhe mirëkuptimit; dhe
- financimin e aktiviteteve të ndryshme për aktivizimin dhe ndërveprimin ndërmjet institucioneve dhe grupeve shoqërore, etj.

12. FAMILJA DHE INDIVID I SI FAKTORË PARANDALUES DHE KUFIZUES

Duke qenë se familja është qeliza e parë themelore e shoqërisë në të cilën krijohet personaliteti i individit dhe qytetarëve, si dhe duke pasur parasysh se fenomenet e ekstremizmit, radikalizmit dhe terrorizmit lidhen me indoktrinimin e individit nga

grupet ekstremiste, ajo ka një rol tepër të rëndësishëm në parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit, radikalizmit dhe terrorizmit. Ndër veprimet dhe aktivitetet kryesore që familja mund të luajë në këtë drejtim janë:

- edukimi dhe mbrojtja e fëmijëve dhe të rinjve me parimet e tolerancës, bashkëpunimit, korrektësisë, respektit reciprok dhe konkurrencës së ndershme;
- aktivizimi i fëmijëve dhe të rinjve në respekt të natyrës dhe mjedisit që i rrethon;
- edukimi i fëmijëve dhe të rinjve me idenë e punës dhe kalimit të vështirësive përmes saj dhe aktiviteteve personale profesionale;
- nxitja tek fëmijët e aftësive kritike të të menduarit dhe arsyetuarit;
- kundërshtimi i dhunës, pranimi i ideve të reja dhe respekti e pranimi i tolerancës dhe koncepteve e praktikave të ndryshme;
- nxitja e fëmijëve për të adresuar raste të dhunës në familje dhe jashtë saj;
- edukimi i vazhdueshëm dhe trajnimi sipas mundësive;
- krijimi i kontakteve me komunitetin, shoqërinë civile dhe organet vendore për të kuptuar dhe identifikuar në familje anëtarët me prirje dhe ide radikale dhe ekstremiste; dhe
- mbajtjen e lidhjeve të vazhdueshme dhe të ngushta me shkollën dhe komunitetin me qëllim parandalimin e përfshirjes së fëmijëve në fenomenet e mësipërme.

13. ROLI QË MUND TË LUAJNË NË PARANDALIMIN E FENOMENIT SHOQËRIA CIVILE, BESIMET DHE ORGANIZATAT FETARE

Një aspekt i rëndësishëm i parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit është krijimi i njohurive dhe vetëdijes fetare midis njerëzve me qëllim parandalimin e depërtimit të doktrineve dhe ideologjive ekstremiste. Ndër aktorët kryesorë të cilët mund të ndikojnë pozitivisht në luftën ndaj fenomeneve të ekstremizmit, fundamentalizmit dhe terrorizmit janë shoqëria civile dhe organizatat fetare. Kjo, pasi në një pjesë të konsiderueshme të rasteve individët të cilët janë subjekte të këtyre fenomeneve nuk kanë aspak besim në organet shtetërore, madje në shumë raste janë këto të fundit shkaqet që i kanë shtyrë ato të bëhen pjesë e rrymave dhe/ose grupimeve të tilla. Për më tepër, në kohët moderne një pjesë e konsiderueshme e aktiviteteve ekstremiste, fundamentaliste dhe terroriste janë ndikuar dhe frymëzuar nga ideologji me sfond fetar dhe ndikimi që organizmat fetarë kanë mbi to është i konsiderueshëm.

Në këto kushte, afërsia territoriale dhe lokalizmi i tyre, njohjet dhe lidhjet e drejtpërdrejta shoqërore, mungesa e një paragjykimi për veprimet e pushtetit dhe besimi e shumëllojshmëria e veprimeve dhe/ose fushatave që mund të kryejnë ndikojnë që, si organizmat joqeveritarë të shoqërisë civile, ashtu edhe organizatat

fetare mund të ndikojnë pozitivisht në kundërshtimin dhe luftimin e fenomeneve të ekstremizmit, fundamentalizmit dhe terrorizmit.

Promovimi i tolerancës dhe mirëkuptimit fetar, sqarimi i koncepteve dhe teologjive fetare nga teologë të mirëfilltë, të shkolluar dhe ithtarë të tolerancës mund të ndikojë në zvogëlimin e fenomenit që mund të nxitet nga bindje dhe teori të gabuara fetare.

Ndër veprimet dhe aktivitetet kryesore që shoqëria civile dhe organizatat fetare mund të luajë në këtë drejtim janë:

- promovimi i tolerancës dhe mirëkuptimit fetar,
- edukimi i komunitetit me koncepte dhe teologjitë fetare nga teologë të mirëfilltë, të shkolluar dhe ithtarë të tolerancës që të ndikojë në zvogëlimin e fenomenit që mund të nxitet nga bindje dhe teori të gabuara fetare;
- ndërmarrja e fushatave sensibilizuese nga shoqëria civile, për përhapjen e njohurive në lidhje me ekstremizimin e dhunshëm dhe rreziqet e tij;
- krijimi i lidhjeve ndërmjet shoqërisë civile dhe komuniteteve fetare me familjen dhe shkollën me qëllim parandalimin e indokrinimit të fëmijëve me idetë ekstremiste dhe evidentimin e rasteve të tilla që në gjenezë; dhe
- edukimin e fëmijëve me ndjenjën e tolerancës dhe bindjeve fetare apo mungesës së besimit.

14. BASHKËPUNIMI NDËRMJET AKTORËVE TË NDRYSHËM, VEÇANËRISHT KOMUNITETIT DHE ORGANEVE VENDORE PËR PARANDALIMIT DHE LUFTËN NDAJ KËTIJ FENOMENI

Parandalimi dhe luftimi i fenomeneve të ekstremizmit, ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit kërkon një bashkëpunim të qenësishëm ndërmjet komunitetit dhe organeve vendore në këtë drejtim që të arrihen rezultate pozitive. Duke qenë se individët dhe grupet shoqërore më të marginalizuara nga këto fenomene mbetëm fëmijët dhe gratë, ato janë më të prekur nga fenomenet e mësipërme në një komunitet. Kështu bashkëpunimi mes komunitetit dhe organeve vendore duhet të ketë në fokus ndihmën ndaj këtyre shtresave, që shpesh shpresën e fundit e kanë pikërisht tek organet vendore dhe komuniteti ku jetojnë. Konkretisht, duhet të evidentohen problematikat në zonë dhe të ndërmerren masa për t'i adresuar ato. Fenomenet e ekstremizmit, atij të dhunshëm dhe radikalizmit janë probleme afatgjata dhe përpjekjet në parandalimin dhe luftën ndaj tyre janë të nevojshme të ndërmerren gjithashtu në një afat të gjatë. Për pasojë, edhe bashkëpunimi dhe bashkërendimi i angazhimit të komunitetit me organet vendore duhet të trajtohet në këtë perspektivë.

Ndër veprimet dhe aktivitetet kryesore që komuniteti dhe organet vendore mund të luajnë në këtë drejtim janë:

- angazhimi i komunitetit në aktivitete të ndryshme me karakter kulturor, edukativ dhe sportiv. Organet vendore, por dhe shoqëria civile duhet të

ndërmarrin përmes investimeve aktivitetet të tilla, të cilat orientojnë të rinjtë për të qenë më të hapur, më bashkëpunues dhe të forcojnë ndjenjën e komunitetit;

- përmirësimi i standardit jetësor në komunitet duke u mbështetur nga organet vendore në nxitjen e aktiviteteve në sektorë të ndryshëm ekonomikë, si bujqësi, etj.;
- angazhimi i prindërve në shkollë duke forcuar bashkëpunimin ndërmjet kësaj të fundit dhe familjes si dhe pushtetit vendor;
- angazhimi dhe përfshirja e grave nga autoritetet lokale në projekte të cilat lidhen me çështje të mbrojtjes së të drejtave të tyre, rolit dhe ndikimit të tyre në vendimmarrje, në nivel lokal në komunitet, por dhe në nivel qendror; dhe
- forcimi i bashkëpunimit dhe lidhjes së komuniteti dhe organeve lokale të ruajtjes së rendit përmes të cilave forcohet roli dhe prania e tyre në komunitet. Programe dhe aktivitete të përbashkëta të komunitetit me organet e ruajtjes së rendit në drejtim të rritjes një njohurive të komunitetit për ndihmën që mund të marrë prej këtyre organeve dhe organizmave për evidentimin dhe raportimin e rasteve të dhunës, sidomos në familje.

15. KONKLUZIONE

Bazuar në sa më sipër, në lidhje me fenomenet e ekstremizmit, ekstremizmit të dhunshëm, radikalizmit dhe terrorizmit, mund të konkludojmë se:

- Fenomenet e ekstremizmit të dhunshëm, radikalizmit dhe terrorizmit janë fenomene të ngjashme dhe të ndërlidhura, të cilat mund të ndikojnë negativisht në shoqëri të caktuara kur ekzistojnë kushtet e nevojshme;
- Shkaqet e lindjes së këtyre fenomeneve janë të shumta dhe është e vështirë të identifikohen një numër i vogël që ndikojnë në rritjen dhe zhvillimin e tyre;
- Ndër shkaqet kryesore që ndikojnë në lindjen dhe zhvillimin e këtyre fenomeneve mund të përmendim: vështirësitë ekonomike, prapambetjen sociale dhe kulturore dhe ndjenjën e diskriminimit;
- Për të luftuar këto fenomene duhet një bashkëpunim i gjerë ndërmjet institucioneve qendrore dhe vendore dhe shoqërisë civile e organizatave fetare, duke i dhënë rëndësi veçanërisht, parandalimit të tyre;
- Luftimi i ideologjive radikale përmes aktiviteteve, aktivizimeve dhe promovimeve të figurave tolerante, është i nevojshëm për shmangien e këtyre fenomeneve;

- Pavarësisht rëndësisë mbi parandalimin, miratimi dhe zbatimimi i legjislacionit për kriminalizimin dhe dënimin e këtyre aktiviteteve është i nevojshëm;
- Bashkëpunimi për parandalimin dhe luftimin e tyre nuk duhet të kufizohet vetëm në nivelin rajonal, ose kombëtar, por dhe ndërkombëtar, pasi fenomeni përgjithësisht ka një karakter ndërkombëtar dhe shpesh nxitet nga ideologji fetare ose të natyrave të tjera të cilat nuk njohin dhe as respektojnë kufijtë shtetërorë.
- Pavarësisht se këto fenomene janë njohur dhe zhvilluar gjatë të gjithë historisë njerëzore, aspektet dhe shfaqjet e tyre të dhunshme kanë pësuar një përhapje të gjerë në kohët moderne, gjë që e rrit mundësinë e zhvillimit të tyre dhe në vendin tonë. Ekzistenca e disa rasteve praktike të përshkruara në Raport e pasqyron dhe shpreh më tej këtë rrezik.

16. BIBLIOGRAFI

Ndër dokumentet që kanë shërbyer si burime dhe bazë për hartimin e këtij Raporti janë si më poshtë vijon:

- Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës penale i Republikës së Shqipërisë;
- Vendimi i KM Nr. 930 datë 18.11.2015 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe plani i veprimtimit”.
- Vendimi Kuadër i BE për Luftën kundër Terrorizmit, 2002.
- Raporti i Departamentit Amerika të Shtetit për Luftën kundër Terrorizmit, 2014.
- Vendimi nr. 58 datë 03.05.2016 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.
- Vendimi nr. 46 datë 04.05.2017 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.
- Vendimi Nr. 1 datë 24.01.2018 “Për dërgimin e çështjes në gjyq” i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda”.
- Vendimi nr. 188 datë 25.04.2015 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.
- Vendimi nr. 8 datë 06.02.2017 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.
- “*The Coming Balkan Khalifate: The Threat of Radical Islam to Europe and the West*”, Christofer Deliso.
- “*Marginalization, perceived abuse of power pushing Africa’s youth to extremism – UN study*” 7 Shtator 2017, <https://news.un.org/en/story/2017/09/564472-marginalization-perceived-abuse-power-pushing-africas-youth-extremism-un-study>.
- UNDP “*Journey to Extremism in Africa: Drivers, Incentives and the Tipping Point for Recruitment*” <http://journey-to-extremism.undp.org/content/downloads/UNDP-JourneyToExtremism-report-2017-english.pdf>.